

VENDIM
Nr.30, datë 14.7.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtar i	'''
Hajredin Fuga	Anëtar i	'''
Franc Jakova	Anëtar i	'''
Kristofer Peçi	Anëtar i	'''
Alfred Karamuço,	Anëtar i	'''
Kujim Puto	Anëtar i	'''
Sokol Sadushi,	Anëtar i	'''
Zija Vuç	Anëtar i	'''

me sekretare Drita Filto më datë 28.5.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.17 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: GJERGJ MOLE i përfaqësuar me prokurë nga avokate Ksanthipi Begeja dhe avokat Agim Tartari.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. DHIMITËR MBORJA

2. EFTI MANOLI

3. AMALIA BENDO, të përfaqësuar të tre me prokurë nga avokat Qemal Stafa.

4.BASHKIA E TIRANËS, në mungesë.

5. KOMISIONI I KTHIMIT DHE I KOMPESIMIT TË PRONAVE

ISH-PRONARËVE, RAJONI NR.3 TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI:

1. Deklarimin antikushtetues të vendimit nr.1583, datë 27.11.1997 të Gjykatës së Kasacionit; vendimit nr.1380, datë 7.5.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.9583, datë 2.12.1996 të gjykatës së rrethit Tiranë.

2. Deklarimin e papajtueshmërisë me ligjin të vendimit nr.33, datë 12.1.1994 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Kërkuesi ka parashtuar si shkaqe për shfuqizimin e këtyre vendimeve shkeljen nga ana e tri gjykatave të kërkesave të neneve 38 e 40 të ligjit për "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut", të cilat bëjnë fjalë për një proces të rregullt ligjor dhe një gjykim të drejtë.

Përsa i përket vendimit nr.33, datë 12.1.1994, këto shkelje konsistojnë në këto drejtime: çështja është gjykuar nga një gjyqtar në vend që të gjykohej me trup gjykues të përbërë prej një gjyqtari e dy ndihmësgjyqtarëve, sepse vlefata e padisë e kalonte disa herë shumën 50.000 lekë; ky gjykim është zhvilluar në mungesë të trashëgimtarëve të Aleksandra Ilos pa u thirrur këta si të paditur dhe pa iu komunikuar atyre dita e gjyqit me fletë-thirrje ose me shpallje. Pra është cenuar parimi i kontradiktorialitetit.

Përsa i përket vendimeve të tjera objekt kërkese, të tria gjykatat kanë shkelur edhe parimet themelore të Kodit të Procedurës Civile dhe konkretisht atë që ka të bëjë me kuptimin dhe përmbajtjen e gjësë së gjykuar si edhe me fuqinë provuese të vendimit gjyqësor ndaj personave që nuk janë thirrur në gjykim.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi shpjegimet e përfaqësuesit të kërkuesit, të njërit prej subjekteve të interesuara dhe të përfaqësuesit të tyre,

VËREN:

Shkaqet e parashtuara nga kërkuesi Gjergj Mole për deklarimin antikushtetues të vendimeve gjyqësore, objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese janë të drejta dhe të bazuara.

Këto vendime i përkasin dy çështjeve civile që janë gjykuar në gjykatën e rrethit Tiranë, njëra në vitin 1994 dhe tjetra në një periudhë të mëvonshme. Për të parën, vendimi ka marrë formën e prerë

pa u ankimuar, kurse për çështjen e dytë gjykimi ka kaluar në Gjykatën e Apelit dhe më pas edhe në Gjykatën e Kasacionit.

Ndonëse ndërgjyqësia, shkaku i padisë dhe pozita procedurale e palëve kundërshtare në këto çështje kanë qenë të ndryshme, objekti i kërtimeve të tyre ka qenë i njëjtë. Secila palë ka insistuar të njihet pronare e vetme dhe t'i mohojë palës tjetër të drejtën e bashkëpronësisë mbi një banesë katërkatëshe me 12 dhoma e tre dyqane në katin e parë, e ndodhur kjo në hyrje të Rrugës së Durrësit të qytetit të Tiranës.

Në vitin 1950 me dekret-ligjin nr.801 kjo banesë është shtetëzuar vetëm në emër të Aleksandra Ilos, trashëgimlënësës së kërkuarit Gjergj Mole. Megjithatë Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Rajonit nr.3 Tiranë, nuk ia ka kthyer atë vetëm asaj. Me vendimin e tij nr.46, datë 13.09.1993 ai krahas së lartpërmendurës, i ka kthyer pjesën takuese në këtë pasuri edhe Krisavgji Mborjes, trashëgimlënësës së tre subjekteve të interesuara, Dhimitër Mborja, Efti Manolo dhe Amalia Bendo, por pa përcaktuar madhësitë e këtyre pjesëve. Njohjen e tyre si bashkëpronare në këtë godinë, ai e ka bazuar në faktin se ato figurojnë në regjistrat e ipotekës si ish-pronare në sasi të caktuara, por të pandarë në kufij, të trullit që ndodhet nën godinë ose përreth saj.

Gjykata Kushtetuese pa i hyrë analizës së provave dhe zgjidhjes së çështjes në themel, por duke e përqëndruar kontrollin e saj vetëm në respektimin e normave kushtetuese nga ana e gjykatave të zakonshme që janë marrë me shqyrtimin e këtyre padive, del me konkluzionin se në të gjitha këto gjykime janë lejuar shkelje të rënda të cilat i bëjnë këto procese të parregullta nga pikëpamja kushtetuese.

Shkelje të tilla për vetë karakterin dhe natyrën e tyre dëshmojnë se Aleksandra Ilos ose trashëgimtarëve të saj, u është hequr e drejta e pronës mbi këtë pasuri të palujtshme, në kundërshtim me nenin 38 të Ligjit Kushtetues për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Kështu, me vendimin nr.33, datë 12.01.1994 të gjyqtarit të vetëm të gjykatës së rrethit Tiranë, që ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, janë njohur pronarë të kësaj pasurie vetëm trashëgimtarët e Krisavgji Mborjes duke u përjashtuar nga kjo e drejtë trashëgimtarët e Aleksandra Ilos.

Në radhë të parë në gjykimin e kësaj çështje janë shkelur rregullat mbi kompetencën lëndore. Kjo padi që është vënë në lëvizje nga trashëgimtarët e Krisavgji Mborjes dhe që për shkak të rëndësisë së objektit të saj, kishte një vlerë mbi 50.000 lekë është gjykuar nga një gjyqtar i vetëm. Pra, është vepruar në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr.7537, datë 17.12.1991 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, ku parashikohej se shqyrtimi i këtyre padive duhej të bëhej me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar e dy ndihmësgjyqtarë.

Së dyti, pala paditëse duke kërkuar njohjen e saj si pronare e vetme të shtëpisë katërkatëshe ka kontestuar indirekt, jo vetëm të drejtën e pronësisë në këtë pasuri të Aleksandra Ilos ose të trashëgimtarëve të saj, por edhe bazueshmërinë e vendimit të sipërm të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë së Tiranës. Nga kjo del se në rastin konkret kemi të bëjmë me një padi e cila kërkon një gjykim me palë kundërshtare. Këtë padi gjykata formalisht e ka trajtuar si të tillë, sepse ka thirrur si të paditur Bashkinë e Tiranës dhe ka dalë me vendim detyrues, por në realitet ajo e ka shqyrtuar atë thjeshtë si kërkesë për vërtetimin gjyqësor të një fakti juridik. Kjo mënyrë procedimi, duke mos siguruar një gjykim kontradiktor dhe për më tepër duke mos u njoftuar të marrin pjesë si të paditur në gjyq Aleksandra Ilo ose trashëgimtarët e saj dhe Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, përbën një shkelje tjetër të normave të ligjit kushtetues, të cilat garantojnë realizimin e së drejtës së mbrojtjes në gjyq.

Mosrespektimi i kërkesave të këtij ligji vërehet edhe në gjykimin e çështjes tjetër civile të përfunduar me vendimin nr.9583, datë 02.12.1996 të kësaj gjykate, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit.

Në këtë çështje që është vënë në lëvizje nga kërkuari Gjergj Mole, prania e këtyre shkeljeve vërehet në konkluzionet e pranuar në vendimet përfundimtare të dhëna nga gjykatat e të tria shkallëve.

Kështu, në vendimin nr.9583, datë 02.12.1996 të gjykatës së rrethit dhe në atë me nr.1380, datë 07.05.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, çështja në shqyrtim është trajtuar si gjë e gjykuar. Për këtë të dyja këto gjykata i janë referuar vendimit nr.33, datë 12.01.1994 të gjykatës së rrethit Tiranë me të cilin është gjykuar çështja pa u thirrur si të paditur as trashëgimtarët e Aleksandra Ilos, as Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Në rastin konkret kjo çështje nuk përbën gjë të gjykuar, sepse palët ndërgjyqëse, shkaku dhe objekti i padisë nuk janë po ato që kanë qenë në çështjen e parë të gjykuar në vitin 1994 nga gjyqtari i

vetëm i gjykatës së rrethit Tiranë.

Nga ana tjetër, vendimi që ka dhënë ky i fundit nuk ka fuqi provuese ndaj kërkuesit ose Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të cilët nuk kanë marrë pjesë në këtë gjykim. Për herë të parë këta kanë marrë pjesë me kërkime të pavaruara në gjykimin e dytë duke vepruar njëri në cilësinë e paditësit dhe tjetri me cilësinë e të paditurit.

Shkelje të procesit të rregullt ligjor vërehen edhe në vendimin nr.1583, datë 02.12.1997 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, i cili për më tepër është edhe alogjik. Ndërsa në pjesën arsyetuese të tij pranohet se kërkuesi është bashkëpronar në banesën objekt padie, (ndryshe nga ç'ka pranuar Gjykata e Apelit) në dispozitiv është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Apelit, kur ky në mënyrë të shprehur nuk ia ka njohur atij këtë të drejtë.

Në këto rrethana, të gjitha vendimet gjyqësore të dhëna për të dyja këto padi janë antikushtetuese, sepse janë në kundërshtim me nenin 38 të Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993 për "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut", sipas të cilit: "Liria, prona ose të drejtat e pranuar me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor".

Prandaj, çështja duhet të shqyrtohet edhe një herë nga e para duke iu dërguar për rigjykim gjykatës së rrethit Tiranë, e cila në mbështetje të nenit 170 të Kodit të Procedurës Civile të shikojë mundësinë e bashkimit të dy palëve në një çështje të vetme.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", njëzëri,

VENDOSI:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.33, datë 12.1.1994 të gjyqtarit të vetëm të gjykatës së rrethit Tiranë; vendimit nr.9583, datë 2.12.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; vendimit nr.1380, datë 07.05.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.1583, datë 27.11.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, si dhe dërgimin e akteve për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.